Drejtoria e Planifikimit te Territorit, Bujqesise, Veterinarise dhe Administrimit te Pyjeve

- **Leje zhvillimi**

1. Dokumenti I lejes së zhvillimit permban në nivel njësie :
a. Përdorimin e tokave dhe strukturat e lejueshme
b. Intesitetin e ndërtimit
c. Koeficientin e shtytëzimit të tokës për ndërtim
d. Lartësinë maksimale në metra
e. Distancat
f. Gjelbërimin publik
g. Parkimin
h. Fragmenti I hartës në gjendjen ekzistuese
i. Projektidenë arkitektonike të zhvillimit
j. Informacion rreth kufizimeve dhe kushtëzimeve
2. Permban volumetrinë e së drejtës së zhvillimit të pronës dhe truallin.
3. Në rast ndyshimi të statusit apo kufijve të pronës, zhvilluesi duhet të aplikojë për leje të re zhvillimi.

Dokumentacioni I nevojshëm për pajisjen me leje zhvillimi

1. Kërkesa për leje sipas formatit të aplikimit sipas percaktimit në systemin elektronik të lejeve.
2. Prokura/ autorizimi në emër të personit juridik /fizik në rast se kërkesa paraqitet nga përfaqësues I zhvilluesit.
3. Dokument që vërteton të drejtat pasurore mbi pronën që do zhvillohet
4. Plan rilevimi të pronës në shkalle 1:500, nga topograf i liçencuar.
5. Projektide arkitektonike të zhvillimit
6. Kopje e liçencës së topografit dhe projektuesit
7. Mandatpagesa e tarifes se aplikimit

- **Leje ndërtimi**

Punimet që kërkohet pajisja me leje ndërtimi perfshijnë:

a. Rezultojnë në krijimin e ndërtimeve të reja, përfshirë ato të përkohshme
b. Rikonstruksion, rikonstruksion dhe restaurim që çojnë në krijimin e një strukture tërësisht ose pjesërisht.
c. Realizojnë mirëmbajtje të jashtëzakonshme të shoqëruar me ndryshime te sistemit konstruktiv të objektit
d. Kanë si pasojë prishjen e objekteve, në rast se prishja nuk shoqërohet me ndërtim të ri. Nëse prishja shoqërohet me ndërtim të ri, leja për prishje është pjesë e lejes së ndërtimit dhe shënohet në kushtet e dokumentit të lejes.

Dokumentacioni i nevojshëm për pajisjen me leje ndërtimi:

1. Kërkesa për leje ndërtimi sipas formatit të aplikimit të përcaktuar ne systemin elektronik të lejeve.
2. Dokumente që vërtetojne të drejta pasurore të pronave që marrin pjesë ne zhvillim.
3. Plani I vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës
4. Projekti I plote arkitektonik dhe relacioni përkatës te nënshkruar elektronikisht
5. Grafiku paraprak I punimeve dhe afati I dorezimit te objekteve
6. Deklarata e projektuesit te liçencuar sipas formatit ne sistemin elektronik te lejeve
7. Mandatpagesat e tarifave te aplikimit
8. Kopje e policës së sigurimit te projektuesve për mbulimin e përgjegjësive profesionale
9. Lejet, liçensat, autorizimet per ushtrimin e aktivitetit
10. Projekti i ndërtimit (projekti arkitektonik, projekti konstrukstiv, projekti hidrosanitar, ngrohje-ftohje, elektrike, projekti I mbrojtjes nga zjarri, projekti I efiçencës enegjitike)
11. Për prishjen e objekteve
    a. Kërkesa për leje ndërtimi sipas formatit të aplikimit të përcaktuar ne sistemin elektronik të lejeve.
    b. Dokument pronësie që vërtetojnë të drejtat pasurore
    c. Raport Teknik I ekspertëve mbi gjendjen fizike, ndërtimore
    d. Mandatpagesa e tarifave të aplikim

❖ **<u>Çertifikatë përdorimi</u>**

1. Në përfundim të proçesit të zhvillimit aplikuesi paraqet kërkesën per tu pajisur më çertifikatë pëdorimi së bashku me proces-verbalin e kolaudimit dhe deklaratën teknike se: objekti është ndërtuar në përputhje me projektin.
2. Nëse aplikuesi nuk paraqet dokumentacioni brenda afatit 15 ditor autoriteti përgjegjës merr vendim për refuzimin e kerkesës për lëshimin e çertifikatës së përdorimit.
3. Brenda 10 ditëve nga paraqitja e raportit të vlerësimit , jo më vonë se 30 ditë pune nga data e dorëzimit të proces-verbali të kolaudimit Kryetari vendos:

- Lëshimin e çertifikatës së përdorimit të objektit që vërteton përfundimin e punimeve në përputhje me kushtet e lejes.

4. Nëse autoriteti përgjegjës nuk lëshon çertifikatën e përdorimit brenda afatit të përcaktuar atëherë kërkesa gjeneron vendimin e miratimit.

Sherbimet qe ofrohen nga Drejtoria

1. Pajisja me autorizim per punimet qe nuk kerkojne leje ndertimi
2. Plan vendosje te objekteve
3. Shqyrtimi I kerkesave dhe ankesave te qytetareve
4. Shqyrtimi I dokumentacionit per leje Zhvillimi/ Ndertimi
5. Vertetim per sistemin e adresave
6. Vertetim per perfitim te tokes bujqesore
7. Vertetim per perberjen familjare
8. Vertetim per strehimin